



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.03.2024
REFERENC-Ë:	6690-2/2023 – ARPL 2024
PËR/ZA/TO:	" SYLA GROUP " SH.P.K , Rruga 17 Shkurti, Klinë e Poshtme , Skenderaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarittë Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL- së
NGA/OD/FROM:	Mevlane KUKA , Zyrtare për planifikim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 6690-2/23, për Shkarkim të ujërave të ndotura nga baza mobile e prodhimit të betonit nga pala „SYLA GROUP “ SH.P.K dhe ka vendosur si në Vendimin për Leje Ujore - Shkarkim të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë: 27.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjenive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „SYLA GROUP” SH.P.K me nr. prot. 6690-2/23, për **LEJE UJORE PËR SHKARKIMIN E UJËRAVE** nga baza mobile e prodhimit të betonit me koordinata: (Y=7 483 432.542 ; X =4 734 979.695) në ngastrën. P-720-150025-01443-1;00443-2,00443-3,00443-4 sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore për Shkarkim e ujërave lëshohet në bazë të Dokumentacionit tekniko - investiv për shkarkimin e ujërave nga baza mobile e betonit .
2. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues, kualitativ dhe kuantitativ (temperatura, ph, SHBO₅, SHKO, sasia materieve të suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, paratrajtimi për specifikat e recipientit - kanalizimi publik, duhet prezantuar në MMPHI, ;
3. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;

4. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe t'i kompensoj;
5. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçant, rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjasht muaj;
6. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. MMPH –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor”.
7. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore për shkarkim nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore;
8. Afati i lëshimit të lejes ujqore është 5 (pesë) vite me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujqore për shkarkim bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujqore për shkarkim;
10. Validiteti i Lejes Ujqore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nga pala për aplikim me kërkesën me nr.protokoli 6690/23 date: 14.11.2023 dhe duke bashkangjitur dokument shtese me nr protokollit.6690-2/23 te datë: 27.03.2024 ka shqyrtuar: Dokumenti tekniko –investiv i pusit të ujit në parcel nr P-720-150025-01443-1;00443-2,00443-3,00443-4, Marrëveshje bashkëpunimi “SYLA GROUP” SH.P.K dhe Alpha Zerol Sh.p.k , Çertifikata e regjistrimit të biznesit ” SYLA GROUP ”Sh.p.k, Kopja e Planit , Vendim-Pëlqim Mjedisor,Licencë- Kompani e licencuar , “Gjeodeti” sh.p.k , Kopja e lejes se njoftimit e Blerim Halilaj, Harta e Situacionit te Betonjerkës, Harta e situacionit , Situacioni Gjeodezik , Koordinatat e matura per situacionin, Çertifikata e regjistrimit të biznesit “ Alpha Zerol ” sh.p.k, Diplome e Esat Bislim Mehani, Diplome e Veton Liman Elshani , Sedimentuesi per trajtimin e ujqerave nga kopania “SYLA GROUP”Sh.p.k, Rrjeti hidrografik , Harta gjeologjike, Procesi teknologjiki prodhimit te betonit, Skema teknologjike, Analiza e shkarkimit te ujqerave , Analiza e kost-benefites te projektit Situacioni i terrenit.

Faturat e paguara me rastin e aplikimit për (Kushte Ujqore , Pëlqim Ujqor , Leje Ujqore); CD-në.

Andaj bazuar në atë siç u tha më sipër, bazuar në Legjislacionin e ujërave të Kosovës; bazuar në shikimit në vend me ç’rast është mbajtur edhe procesverbali i nënshkruar nga të dyja palët, është vendosur si në dispozitiv.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 6690-2/23 -ZSP- 2024, Datë: 27.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës se Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës së Skenderajt
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI